

# Statistikat e Bujqësisë 2023

**Tiranë, më 21 Qershor 2024:** Prodhimi i drithërave në vitin 2023 është 701.314 tonë, qarku i Fierit ka nivelin më të lartë me 176.584 tonë, pasuar nga qarqet Elbasan me 95.572 tonë dhe Korçë me 83.889 tonë.

Tab.1 Prodhimi bujqësor (mijë tonë)


Prodhimi bujqësor	2021	2022	2023
			<b>Bimët e arave</b>
Drithëra	691,4	690,9	701,3
Perime	1.338,2	1.357,8	1.384,5
Patate	258,9	262,7	274,2
Fasule	22,4	21,8	23,3
Bimë industriale	27,3	24,5	23,4
Bimë medicinale	16,0	16,4	17,8
Foragjere	7.054,0	7.138,8	6.940,3
			<b>Drufrutorët</b>
Pemë frutore	287,2	295,4	281,9
Ullinj	110,2	157,7	117,6
Agrume	50,5	55,1	56,7
Rrush	212,0	211,2	179,7

Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në vitin 2023, prodhimi i patates është 274.188 tonë, duke shënuar një rritje me 4,38 %, në krahasim me vitin 2022. Qarqet që kanë nivelin më të lartë të prodhimit të patates në vend janë, Korça me 68.428 tonë, Fieri me 53.583 tonë dhe Elbasani me 29.265 tonë. Prodhimi i bimëve industriale në vitin 2023, ka pësuar ulje me 4,36%, ndërsa prodhimi i fasules ka shënuar një rritje prej 7,06%, krahasuar me një vit më parë.

**Për publikim 21/06/2024**

Fig. 1 Prodhimi i drithërave, perimeve dhe patate (mijë tonë)




Burimi : Ministria e Bujqësisëdhe Zhvillimit Rural

Në vitin 2023, prodhimi i perimeve është 1.384.483 tonë. Niveli më i lartë i prodhimit të perimeve është në qarqet Fier me 543.935 tonë, Tiranë me 154.098 tonë dhe Berat me 137.832 tonë.

Perimet e njoma përfaqësojnë 65,91 % të perimeve gjithsej, ndjekur nga bostanoret me 24,08 % dhe perimet e thata me 10,01 %.

Fig. 2 Struktura e prodhimit të perimeve, 2023 ( në %)



Burimi : Ministria e Bujqësisëdhe Zhvillimit Rural

Burimi : Ministria e Bujqësisëdhe Zhvillimit Rural

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>


Në vitin 2023, u prodhuan 912.448 tonë perime të njoma, duke shënuar rënie prej 0,27 %, krahasuar me një vit më parë. Në grupin e perimeve të njoma, kulturat përfaqësuese, janë domatja me 309.343 tonë (33,90 %), kastravec i 128.845 tonë (14,12 %) dhe speci 104.982 (11,51 %).

Prodhimi i perimeve të thata arriti 138.619 tonë, me një rritje prej 6,91 %, krahasuar me vitin 2022, ku qepa e thatë përfaqëson 84,48 % të prodhimit gjithsej të këtij grupi. Gjithashtu, bostanoret arritën prodhimin 333.416 tonë, me një rritje prej 6,44 %, krahasuar me vitin 2022, ku shalqini përfaqëson 84,39 % të prodhimit të këtij grupi.

Prodhimi i perimeve në serra përfaqëson 22,43 % të prodhimit gjithsej të perimeve, nga ku 78,50 % e këtij prodhimi i përket Qarkut Fier dhe Berat.

Në vitin 2023, prodhimi në serra ka një rënie me 0,16 %, krahasuar me një vit më parë. Prodhimi i domates zë 50,40% të prodhimit gjithsej në serra.


**Fig. 3 Prodhimi i perimeve në serra sipas kulturave (në %)**



Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Qarku me përqindjen më të lartë të prodhimit të perimeve në serra ndaj prodhimit të perimeve gjithsej është Berati me 69,04 % dhe Elbasani 29,94 %, përqindja më e ulët është shënuar në qarkun Gjirokastrë me 0,44 % dhe qarku Kukës 0,48 %.

Fig. 4 Prodhimi i perimeve në fushë dhe serrë, sipas qarqeve 2023 ( në %)




Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

### Drufrutorët

Prodhimi i drufrutorëve përfaqësohet nga prodhimi i pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe rrushit.

Fig. 5 Prodhimi i drufrutorëve (mjë tonë)




Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Prodhimi i pemëve frutore në vitin 2023 është 281.936 tonë, duke pësuar rënie me 4,57 %, krahasuar me vitin 2022. Niveli më i lartë i prodhimit të pemëve frutore u arrit në qarkun e Korçës me 74.605 tonë, pasuar nga qarqet Elbasan me 40.504 tonë dhe Fier me 36.313 tonë.

Grupi i pemëve frutore me farë zë 41,54 % të prodhimit, peshën kryesore në këtë grup e zë prodhimi i mollëve, ku vetëm Qarku i Korçës zë 60,81 % të prodhimit të mollëve gjithsej në vend.

**Fig. 6 Struktura e prodhimit të pemëve frutore sipas llojeve dhe qarqeve , 2023 ( në%)**



\* Përfshihet prodhimi i manave dhe të tjera  
Burimi : Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në grupin e pemëve frutore me bërthamë, peshën më të madhe e zënë prodhimi i kumbullave me 45,24%, pasuar nga pjeshkët me 26,05 % dhe qershitë me 22,37 %.

Në vitin 2023, fiqtë zënë 45,97 % të prodhimit në grupin e pemëve frutore subtropikale, pasuar nga hurmat me 26,05 % dhe shegët 24,67 %.

Arrat dhe gështenjat zënë 82,11 % të prodhimit në grupin e pemëve frutore arroje. Niveli më i lartë i prodhimit të arrave në këtë grup është shënuar në Qarkun e Dibrës me 2.411 tonë.

Në vitin 2023, u prodhuan 117.618 tonë ullinj, duke shënuar rënie me 25,42 %, krahasuar me një vit më parë. Varietetet e ullirit për vaj përbëjnë 87,25 % të prodhimit gjithsej dhe varietetet e ullirit për tavolinë përfaqësojnë 12,75 %.

Prodhimi i agrumeve në vitin 2023 është 56.729 tonë. Niveli më i lartë i prodhimit të agrumeve është shënuar në qarkun e Vlorës me 35.834 tonë ose 63,17 % të prodhimit të agrumeve gjithsej. Mandarinat zënë 63,54 % të prodhimit gjithsej të agrumeve në vend.

Në 2023, prodhimi i rrushit është 179.705 tonë, ky prodhim përfaqësohet nga rrushi nga vreshtat me 104.857 tonë (58,35 %) dhe rrushi nga pjergullat me 74.848 tonë ( 41,65 %).

# Metodologjia

Statistikat e bujqësisë për vitin 2022 mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore është Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare dhe Ligji Nr. 30/2022 i Statistikave Zyrtare 2022-2026, gjithashtu duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve Evropiane përkatëse -Rregullorja Evropiane (KE) Nr. 543/2009 mbi Statistikat e Bujqësisë.

Informacioni mbledhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit.

Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, sipërfaqe prodhuese për drufrutorët, prodhim dhe rendiment.

## **Përkufizime**

### **Viti i prodhimit**

Me vit prodhim i nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

### **Klasifikimi**

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grup kulturash (drithëra, perime, bimë industriale, foragjere, farëra vajore, patate, fasule) në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe e dytë.

Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas grupeve kryesore: pemët frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla për numrin e pemëve gjithsej, pemët në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.

### **Sipërfaqja e kultivuar**

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore, specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kulturave të para dhe të dyta. Sipërfaqja e perimeve gjithsej përfaqësohet nga sipërfaqja e perimeve të njoma, të thata dhe bostanoreve. Nga kjo sipërfaqe përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga dëmtues natyror (përmbytjet, zjarre etj).

### **Serrë**

Serrë është ambjenti i mbuluar me xham apo me mbulesë të lartë, (që lejon kalimin e personave apo mjeteve mekanike), të fiksuara apo të lëvizshme (xham ose plastikë e fortë ose fleksibël), ku bimët kultivohen gjatë gjithë periudhës apo për pjesën më të madhe të rritjes saj.

**Pemët frutore**

Pemët frutore përfaqësohen nga frutat farore ( mollë, dardhë, ftua), Frutat bërthamore( kumbulla, qershi, pjeshkë, kajsi), frutat subtropikale( fiq, hurma, shegë), frutat arvore (arra, gështenja, bajame dhe lajthi), dhe te tjera.

**Sipërfaqja prodhuese**

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përfshihen sipërfaqet e pemëtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.